



VENDIM

Nr. 171, Datë 31.10.2016

MBI

**SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE ME NR. 88, DATË
26.09.2011, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË EURON ENERGY
GROUP” SH.P.K, PËR AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE” NR.187, SERIA T11P**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016; nenit 5.2 të “Licensë për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike” miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr.97, datë 17.06.2016; i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 31.10.2016, mbasi shqyrtoi relacionin mbi shfuqizimin e Vendimit të Bordit të ERE-s me Nr. 88, datë 26.09.2011, “Mbi licencimin e shoqërisë Euron Energy Group” sh.p.k, për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, Nr.187, Seria T11P,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Euron Energy Group” sh.p.k, është licensuar në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike, përkatësisht me Vendimet e Bordit të ERE-s, me Nr.87, datë 26.09.2011 dhe Nr. 88, datë 26.09.2011.
- Me shkresën me Nr. 268 Prot., datë 12.03.2015, shoqëria “Euron Energy Group” sh.p.k, ka paraqitur në ERE kërkesën për transferimin e licensës së prodhimit dhe tregtimit tek shoqëritë: “Euron Energy” sh.p.k., “Alb Energy” sh.p.k. dhe “Energal” sh.p.k.
- Me Vendimin nr. 54, datë 23.04.2015, Bordi i ERE-s, ka vendosur transferimin e licensës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Euron Group Energy” sh.p.k, tek shoqëritë: “Euron Energy” sh.p.k., “Alb Energy” sh.p.k. dhe “Energal” sh.p.k.
- Shoqëritë “Euron Energy” sh.p.k dhe “Energal” sh.p.k., kanë aplikuar dhe janë pajisur nga ERE me licensë tregtimi, përkatësisht me vendimet e Bordit të ERE-s, Nr. 92, datë 28.07.2015 dhe Nr. 91, datë 28.07.2015.

- Me shkresën nr. 01 Prot., datë 04.01.2016 kemi marrë dijeni se “Euron Energy Group” sh.p.k ka pushuar aktivitetin e saj, dhe tashmë ka mbyllur edhe procedurat e likuidimit e çrregjistrimit nga Qendra Kombëtare e Rregjistrimit si dhe pranë organeve Tatimore.
- Neni 5.2 i “Licensës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike” miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr.97, datë 17.06.2016 parashikon se: *“Nëse i Licensuari ndryshon statusin e tij ligjor....licensa bëhet e pavlefshme dhe anulohet”*

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shfuqizojë vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 88, datë 26.09.2011, “Mbi licencimin e shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k, për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike nr. 187, seria T11P”.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.